



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.959/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Ekrem Rrahmani nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli Anr.959/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Ekrem Rrahmani nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2948-2021, i datës 03.11.2021, për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.959/2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Ekrem Rrahmani nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, me të cilin kërkon që të bëhet rinumërimi, i vendvotimeve 1804E/01R, 1824R/13R, 1818E/01R dhe 1830E/02D, për shkak se pretendon se në këto vendvotime e kanë votuar disa familjarë e që ato vota tani nuk i figurojnë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Ekrem Rrahmani nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar nga Xhevdet Maloku kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Podujevës, të paraqitur me datën 04.11.2021 dhe me të cilën është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.848/2021 të datës 05.11.2021 dhe është konsumuar edhe çështja e pretenduar me apelin e apeluesit.


Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.848/2021 të datës 05.11.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.959/2021 më datën 06.11.2021

Kryesues i Panelit
Terki Xhaferi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.